

# SNV SHQIPËRI

Menaxhimi në Bashkëpunim i Pyjeve

PROJEKTI I SNV-BB

## Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore

Ngritja e Kapaciteteve të Shoqatave  
të reja dhe ekzistuese të Përdoruesve  
të Pyjeve dhe Kullotave komunale.

Raport Progresi (vjetor) - 2006



Janar 2007

# SNV

Connecting People's Capacities

# SNV SHQIPËRI

## Lidh kapacitetet e njerëzve

Misioni i SNV-së është të sigurojë ndihmë teknike me qëllim lehtësimin e varfërisë dhe përmirësimin e qeverisjes për vendet më pak të zhvilluara. Qëllimi kryesor i SNV-së në Shqipëri është ta ndihmojë këtë të fundit për të zhvilluar dhe zbatuar më tej procesin e decentralizimit dhe të mbështesë qeverisjen e mirë lokale që bën të mundur lehtësimin e varfërisë në një mënyrë të qëndrueshme. Po kështu SNV-ja mbështet përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në Bashkimin Evropian.

Për realizimin e këtij misioni, pranohet si faktor me rëndësi jetike ndërveprimi mes qeverisjes vendore dhe organizatave të shoqërisë civile (si edhe e sektorit privat), ndërveprim ky që mundësohet përmes bashkëpunimit dhe pushtetit kundërveprues. SNV Shqipëri do të përdorë ekspertizën e saj për të përmirësuar dialogun midis autoriteteve dhe qytetarëve, për të shmangur kështu përjashtimet dhe për të realizuar shërbime më të mira për qytetarët. Për ta bërë këtë, SNV Shqipëri po fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve të organizatave partnere të saj.

SNV e nisi aktivitetin e saj në Shqipëri, në 1993. SNV-ja ka aktivitet në tri zona: në qarqet e Dibrës, Fierit dhe Korçës. SNV-ja siguron shërbime konsulence për rritjen e kapacitetit, njohurive dhe qëndrueshmërisë së klientëve të saj. Shërbimet e konsulencës së SNV-së ofrohen mbi bazë të kërkesës së organeve të Qeverisjes Vendore (Komunave, Bashkive dhe Qarqeve) si dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile. Përgjithësisht, SNV-ja përfshihet në partneritete afatgjata, por kjo nuk përjashton edhe sigurimin nga ana e saj të shërbimeve afat-shkurtra. Përhapja e eksperiencave dhe shërbimet e konsulencës në nivel kombëtar sigurohen nëpërmjet zyrës së SNV-së Shqipëri në Tiranë. Fushat ku kryesisht fokusohet SNV-ja janë Qeverisja Vendore e Përgjegjshme, Menaxhimi i Pyjeve në Bashkëpunim, Mundësia e Shfrytëzimit të Tregjeve nga të Varfërit si dhe Turizmi i Qëndrueshëm.

# SNV

Connecting People's Capacities

Zyra e Dibrës/Kukësit, Peshkopi:  
Tel: 0218-2642

Zyra e Fierit, Fier:  
Tel: 03-420302

Zyra e Korçës, Korça:  
Tel: 082-44183

Zyra e Tiranës, Tirana:  
Tel: 04-247601/2  
E-mail: albania-info@snvworld.org

## Përmbajtja

	Lista e akronimeve	3
1	Detajet e projektit	4
2	Hyrje	4
3	Historiku	5
4	Planifikimi	6
5	Aktivitetet	7
6.	Rezultatet	13
7.	Ditët e konsultimit	17
8.	Raporti financiar	16
9.	Planifikimi i katërmujorit të dytë	16

## Lista e akronimeve

PSHP	- Projekti Shqiptar i Pyjeve
PK / APK	- Pyjet Komunale / Administrimi i Pyjeve Komunale
DPPK	- Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave
DSHP	- Drejtoria e Sherbimit Pyjor
DPPK	- (ish) Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave
SHPPKK/SHPP	- Shoqata e Perdoriesve të Pyjeve e Kullotave komunale/ Shoqata e Perdoriesve të Pyjeve
GEF	- Fondi Mjedisor Global
MMPAU	- Ministria e Mjedisit, Pyjeve, dhe Administrimit të Ujërave
SHKPK	- Shoqata Kombëtare e Pyjeve Komunale (gjithashtu: "Shoqata Kombëtare")
PZHBN	- Programi i Zhvillimit të Burimeve Natyrore (gjithashtu: "projekti i BB-së")
PPjD	- Produkte Pyjore jo Drusore
NJMP	- Njësia e Menaxhimit të projektit të BB-së
FR	- Federata Rajonale (e Perdoriesve të Pyllit)
SIDA	- Agjensia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
SNV	- Organizata Hollandeze e Zhvillimit
BB	- Banka Botërore

# 1 Detajet e projektit

<i>ID e projektit të BB:</i>	PO82375
<i>Emri i projektit:</i>	Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore në Shqipëri -Ngritja e Kapaciteteve të Shoqatave të reja dhe ekzistuese të Shfrytëzimit të Pyjeve dhe Kullotave
<i>Zbatuesi:</i>	Organizata Holandeze e Zhvillimit – SNV
<i>Kohëzgjatja e projektit:</i>	5 vjet – Prill 2005 deri Nentor 2010
<i>Financuar nga:</i>	BB/SNV me shumë totale 1,57 milion,- USD
<i>Partnerët kryesorë:</i>	Drejtoria e Politikave Pyjore dhe Kullotave (DPPK)
<i>Vendi i zbatimit:</i>	Shqipëri

# 2 Hyrje

Qeveria Shqiptare ka marrë një kredi nga Banka Botërore dhe një grant nga GEF dhe SIDA, që afërsisht arrijnë shifrën 20 milion USD, për financimin e Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për këtë Projekt, dhe Drejtoria e Politikave Pyjore dhe Kullotave (DPPK) ka përgjegjësi për zbatimin e Projektit me anën e Njësisë së Menaxhimit të Projektit (NJMP).

Komponenti i parë i projektit do të forcojë dhe rrisë përpjekjet e komunitetit për administrimin e pyjeve dhe kullotave sipas Projektit Shqiptar të Pyjeve (PSHP), i cili u mbyll në 2004-ën. Brenda këtij komponenti SNV do të zbatojë masa për ngritjen e kapaciteteve të shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe veprimet kryesore për përmirësimin e administrimit të burimeve pyjore dhe kullotave, siç është parashikuar në pikën A.3.1.

Sipas kërkesës në marrëveshjen midis Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore dhe SNV-së raporti i tremujorit të parë mbulon periudhën prill - gusht 2006. Megjithëse periudha zyrtare e raportimit mbulon vetëm periudhë pesë mujore, raporti i tremujorit të parë i SNV-së do të prezantojë gjithashtu aktivitete përgatitore të filluara para muajit prill si vazhdim logjik i aktiviteteve të vetë SNV-së në pylltarinë komunale. Ky raport mbulon aktivitetet në të gjitha 138 komunitet e financuara nga Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore.

Gjatë viteve të fundit vihet re një interes në rritje nga komunitetet për të menaxhuar pyjet e fshatit vetë në kuadër të pylltarisë komunale. Edhe pse ka pasur mbështetje mjaft të kufizuar nga Drejtoria e Sherbimit Pyjor (DSHP), pylltaria komunale vazhdon të zhvillohet. Rezultatet kanë qënë të mira në mjaft fusha vecanërisht kur pyjet janë transferuar, përdorur dhe menaxhuar sipas familjeve apo fiseve.

Në këtë kuadër strukturat organizative brenda pylltarisë komunale po konsolidohen dhe Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve vazhdojnë të funksionojnë, megjithëse në shumë raste këto shoqata janë ende të dobta. Pas vitit 1996 SHPP-të dhe Komunitetet kanë fituar më shumë përvojë si dhe me praninë e Federatave Rajonale (FR) menaxhimi i pyjeve në nivel lokal u forcua më shumë.

Në nivel kombëtar zhvillimet kryesore gjatë kësaj periudhe kanë qënë miratimi i ligjit të ri mbi pyjet në 4 maj 2005 si dhe struktura e re e DPPK pas zgjedhjeve të fundit parlamentare. Legjislacioni i ri mbi pyjet kundërshtohet shumë nga përdoruesit. Bazuar në këtë ligj disa akte nënligjore duhet të rishikohen e të zhvillohen më tej, disa prej të cilave janë shumë të rëndësishme për pyjet komunale dhe aktorët e tyre. Nga ana tjetër procesi i transferimit të pronave publike nga Shteti për në qeverinë lokale akoma po ecën me ritme të ngadalta.

Pas prezantimit të PZHBN-së të Bankës Botërore në Nëntor 2005, SNV u përzgjedh si kontraktori i vetëm burimi për projektin "Ngritja e Kapaciteteve të Shoqatave të Reja dhe Ekzistuese, të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave". U përcaktua një grup pune dhe zbatimi i projektit filloi me kryerjen e një analize të situatës dhe vlerësimit të nevojave të të gjitha SHPPK-ve në Shqipëri. Drejtori i Drejtorisë së Politikave mbi Pyjet dhe Kullotat u emërua gjithashtu edhe drejtor i NjMP. Njësia e Menaxhimit të Programit (NjMP) përbëhej nga Koordinatori, tre konsulentë (i. Pyjeve Komunale, ii Finance dhe iii Prokurimeve Publike) si dhe 5 koodinatorë rajonal të punësuar për të koordinuar në Rajon. 3-5 specialistë nga DPPK janë në grupin monitorues të NjMP. Konsulenti i pyjeve komunale në NjMP vepron gjithashtu edhe si personi i kontaktit nëpërmjet DPPK dhe SNV.

## 3 Historiku

## 4 Planifikimi

SNV do të përdorë burimet njerëzore të disponueshme në Sportfolet e saj multi-disiplinore në Shqipëri. Në vitin e parë të projektit një total prej 1,010 ditë konsulence do të vendosen në dispozicion për zbatimin e kësaj detyre, të cilat janë ekuivalente me 70 muaj konsulence. Për koordinimin e përgjithshëm do të jetë në dispozicion një konsulent ndërkombëtar me eksperiencë në menaxhimin e pyjeve të komunës (75% të kohës).

Gjatë vitit 2006 ishte përllotatur të harxhoheshin një sasi prej 1000 ditësh konsulence (të ndara: 775 kontributi i SNV-së dhe 225 kontributi i PZhBN), që janë ekuivalente me 380,000 USD (312,500 USD SNV-ja dhe 67,500 USD PZhBN) kosto konsulence (përfshirë pagat dhe kosto të tjera personeli, kosto në lidhje me konsulencën e drejtpërdrejtë (transporti, dietat, etj) dhe tarifatat e menaxhimit). Për kostot e rimbursueshme, janë rezervuar një shumë prej 80,000 USD (për gjithë vitin) meqë pjesa me e madhe e aktiviteteve pritej të kryeheshin për përgatitjen e vlerësimit të nevojave si dhe për përfundimin e propozimit tekniko - financiar, të cilat nuk do të përfshinin trajnimet, workshopet, vizitat për shkëmbim eksperiencash, etj.

Objektivat Specifike	Rezultatet	Aktivitetet
<b>(Detyra 1: analiza e situatës e vlerësimi i nevojave)</b>		
1. Të vlerësohet situata aktuale dhe të identifikohen nevojat për forcim kapacitetesh të Shoqatave dhe Federatave të PPK-ve.	1.1. Mblidhet dhe vihet në dispozicion informacion mbi situatën aktuale në lidhje me kapacitetet, strukturat, statusin ligjor, marrëdhëniet, aktivitetet mundësitë dhe kufizimet e Shoqatave dhe Federatave të PPK-ve.	1.1.1. Përcaktimi I metodologjisë indikative për të analizuar e vlerësuar situatën aktuale
		1.1.2 Krijimi e vendosja e grupeve të punës për vlerësimin e nevojave në federatat rajonale e federatën kombëtare
		1.1.3 Trajnimi I grupeve të punës mbi zbatimin e metodologjisë së vlerësimit
		1.1.4 Grupet e punës kryejnë analizën e situatës e vlerësimin e nevojave të SHPPK e Federatave
		1.1.5 Analizimi I informacionit të mbledhur e identifikimi paraprak I nevojave për forcimin e kapaciteteve
		1.1.6 Trajnim I vazhdueshëm I grupeve të punës nga SNV
	1.2. Përcaktohen pika referimi dhe standarte për një funksionim të përmirësuar të Shoqatave dhe Federatave të PPK-ve.	1.2.1. Takime me aktorë kryesorë: MMPAU, Qeverisjet Vendore, Federatat e të tjerë, për të vlerësuar vizionin e tyre mbi funksionimin e dëshiruar të SHPPK-ve
		1.2.2 Përcaktimi e rënia dakort mbi treguesit e kriteret për situatën e dëshiruar të funksionimit të SHPPK-ve e Federatave
	1.3. Përgatitet, bazuar në rezultatet e analizës së situatës dhe në pikat e referimit dhe standartet e përcaktuara, një vlerësim i përgjithshëm i nevojave të Shoqatave dhe Federatave të PPK-ve, për forcim kapacitetesh.	1.3.1. Përcaktimi I mospërputhjeve ndërmjet situatës aktuale e pikave të referimit e standardeve
		1.3.2. Ri-vlerësimi I pikave të referimit e standarteve nëse shihet e nevojshme

Specific Objectives	Results	Activities
		1.3.3. Vënia në përparësi e nevojave për forcimin e kapaciteteve në këshillim me aktorët kryesorë si dhe në marrëveshje me objektivat e projektit
		1.3.4. Përgatitja e planit për forcimin e kapaciteteve
	1.4. Krijohet një bazë e plotë të dhënash për SHoqatat dhe Federatat e PPK-ve.	1.1.1. Krijimi I një baze të dhënash me informacion të mbledhur nga bazat nga analiza e situatës
		1.1.2. Përditësim I vazhdueshëm I bazës së të dhënave
<b>(Detyra 2: programi i ngritjes së kapaciteteve)</b>		
2. Forcimi i kapaciteteve të ShPPK-ve për të qenë të efektshëm dhe të qëndrueshëm në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunale	2.1. Të gjitha SHPPK-të funksionojnë mirë në përputhje me statusin dhe kuadrin e tyre ligjorë.	2.1.1. Rishikimi I situatës aktuale të kuadrin ligjor, statuteve dhe rregulloreve të SHPPK-ve ekzistuese si dhe përcaktimi I përmirësimeve të nevojshme sipas nevojave
		2.1.2. Dhënia e kurseve të trajnimit mbi menaxhimin organizativ bazuar mbi vlerësimin e nevojave
		2.1.3. Trajnimi, përkrahja e monitorimi mbi funksionimin e duhur të SHPPK-ve në Federata, QV e DSHP, në përputhje me kompetencat e tyre

## 5.1. Marrëveshja dhe Fillimi i Punës mbi Propozimin Teknik për PZHBN

Aktivitetet e PZHBN filluan me workshopin dy ditor “Ngritja e Kapaciteteve për ShPPK-të”. Gjatë workshopit SNV përfundoi propozimin teknik dhe financiar: kuadrin logjik, metodat, treguesit, kuadrin kohor, mundësia e burimeve njerëzore, buxheti dhe strategjia për zbatimin e projektit.

Pas workshopit u përcaktuan grupet e punës me pjesëmarrjen e SNV dhe Federatave të SHPPK-ve. Gjashtë grupe pune u përcaktuan të përgatisnin: 1. Dokumentin përfundimtar mbi propozimin e projektit, 2. Metodologjia për vlerësimin e nevojave të SHPPK-ve, 3. Rishikimin e Statutit të SHPPK-ve, 4. Rishikimin e materialeve ekzistuese dhe identifikimin e nevojave për modulet e reja, 5. Përgatitjen e kriterëve për përzgjedhjen e grupeve të intervistuesve dhe trajnerëve si dhe 6. Shpërndarjet e materialeve të shkruara tek SHPPK-të.

## 5.2. Vlerësimi i Nevojave të të gjitha SHPPK-ve ekzistuese

### 5.2.1. Përgatitja e pyetësorëve (Mars – Prill '06).

Grupet e punës përgatitën draftin e parë të pyetësorëve të cilat iu dërguan konsulentëve të tjerë të SNV-së për komente e sugjerime. Me marrjen e komenteve u përgatit një draft i dytë

# 5 Aktivitetet

për të filluar më pas me testimin pilot të pyetësorëve. U punësua një statisticien nga SNV për të përlllogaritur kuadrin logjik si dhe saktësinë e pyetësorëve bazuar në katër popullata të ndryshme. (Kryetarët e Komunave, Bordet e SHPPK-ve, Anëtarët e SHPPK-ve dhe DShP). Për secilën komunë u përcaktua një formacion i veçantë pas përlllogaritjes së nivelit të sigurisë që është 95% si dhe intervali i gabimeve +/- 5%.

#### 5.2.2. Përzgjedhja e intervistuesve (Prill – Maj 2006)

Për përzgjedhjen e intervistuesve grupi i punës përgatiti kriteret të cilat u aprovuan nga Federatat Rajonale dhe Federata Kombëtare.

Katër trajnime u organizuan me intervistuesit në Peshkopi, Tiranë, Korçë dhe Fier. Intervistuesit qartësuan rolin e tyre dhe metodologjinë për plotësimin e pyetësorëve.

#### 5.2.3. Testimi Pilot (Maj 2006)

Vlerësimi i nevojave filloi me testimin pilot të zonave ku SNV është e pranishme (Peshkopi, Korçë, Tiranë/Elbasan dhe Fier). Më shumë se 16 testime pilote u ndërmorën në këto zona.

Pas testimit pilot konsulentët e SNV dhe Federatat u takuan të komentonin dhe reflektonin mbi problemet e hasura gjatë testimit pilot të pyetësorëve, mbi metodat si dhe vlerësimin e metodologjive të përdorura. Bazuar në problematikat e identifikuar gjatë këtij testimi u përfunduan pyetësorët dhe metodologjia për to. (Maj 2006)

Nga ana tjetër përfundoi gjithashtu programi i përpunimit të të dhënave si dhe një bazë të dhënash u zhvillua pas përpunimit të draftit të parë (Maj 2006).

#### 5.2.4. Rimbledhja e të dhënave (Qershor – Korrik 2006)

Për aktivitetet në terren u përgatit një plan pune nga katër zyrat e SNV-së që synonte të mbulonte të gjithë territorin e Shqipërisë. Zyra e SNV-së në Peshkopi mbuloi rajonin e Peshkopisë, Kukësit, Lezhës, Shkodrës dhe Pukës. Zyra e SNV Tiranë mbuloi rajonin e Tiranës, Elbasanit dhe Gramshit. Zyra në Korçë mbuloi rajonin e Korçës, Librazhdit dhe Permetit. Ndërsa zyra e SNV në Fier mbuloi Beratin dhe Gjirokastrën (Qershor 2006).

Në Qershor filloi mbledhja e të dhënave në të gjitha rajonet. U deshën më shumë se dy muaj për të përfunduar grumbullimin e të gjitha të dhënave për aktorët e përcaktuar të menaxhimit të pyjeve komunale (anëtarët e SHPPK-ve, Bordi i SHPPK-ve, Komunitat dhe DShP). (Qershor – Korrik)

#### 5.2.5. Përpunimi i të Dhënave (Gusht 2006)

Përpunimi i të dhënave ishte një pjesë delikate e punës për

përfundimin e grumbullimit të të dhënave. Për këtë arsye një bazë të dhënash u ndërtua nga SNV. Ishte e thjeshtë dhe mund të përdorej nga çdokush që ka njohuri mbi MS Excel. Çdo zyrë e SNV përpunoi informacionin nga grumbullimi i të dhënave. Anëtarë të Federatave u përfshinë gjithashtu në proces. Të gjitha të dhënat e përpunuara u shpërndanë për komente tek intervistuesit e përfshirë. U organizua një workshop me këshilltarët MPB dhe anëtarëve të Federatave për të reflektuar mbi të dhënat e përpunuara. Sugjerime dhe komente u mblodhën nga këshilltarët MPB dhe Federatat dhe i gjithë informacioni u përpunua. Në vijim, SNV organizoi një takim të këshilltarëve të MPB dhe Federatës Kombëtare për të reflektuar mbi interpretimin e pyetësorëve. (*Gusht 2006*).

#### 5.2.6. *Analizimi dhe interpretimi i të Dhënave (Shtator - Tetor 2006)*

Pas përpunimit të të dhënave me programin SPS, këshilltarët e SNV-së punuan për interpretimin e të dhënave duke synuar të identifikojnë dhe analizojnë pyetjet e ashtëquajtura "Flamur të Kuq" nga përgjigjet e sondazhit. Këto përfaqësojnë të dhëna që dëshmojnë për parregullsi në mënyra, shpërndarje, devijime dhe/ose korrelacion. Që këtej e tutje këshilltarët e SNV-së përpunon të përcaktojnë çfarë problemi mund të jetë pas cdo "Flamuri të Kuq". Problemet u analizuan në përputhje me ceshtjet e sondazhit të tilla si: Menaxhimi Organizacional, Aspektet Teknike dhe Nevojat për Mbështetje, Statusi Ligjor dhe Komunikimi, Menaxhimi Financiar, Qëndrueshmëria Financiare dhe Pronësia. Anëtarët e Federatave u përfshinë gjithashtu në proces. Të gjitha të dhënat e përpunuara u shpërndanë për komente tek intervistuesit e përfshirë. U organizua një workshop me këshilltarët MPB dhe anëtarët e Federatave për të reflektuar mbi problemet e identifikuar të sipërpërmendura. Sugjerime dhe komente u mblodhën nga këshilltarët e MPK dhe Federatës dhe i gjithë informacioni i mblodhur u përfshi në raportin e fillimit (raporti i analizës së situatës, raporti i vlerësimit të nevojave dhe raporti i programit të trajnimit).

Skuadrat e MPK punuan për të: 1) përcaktuar si të matnin arritjet e këtij projekti dhe 2) përshkruar situatën aktuale apo kapacitetet që aktorët përfitues kanë për momentin. Grupet ishin ndarë në grupin A (përdorues / anëtarë të SHPPK-ve), grupin B (teknikë dhe anëtarë bordi të SHPPK-ve) dhe grupi C (Federata të SHPPK-ve). Grupet prezantuan rezultatet paraprake si dhe u bënë klasifikimet metodologjike të mëposhtme. Që këtej grupet vazhduan punën e tyre në të njëjtat grupe për të përfunduar detyrën e fundit.

#### 5.2.7. *Seminari Kombëtar, 1 Nëntor 2006*

U zhvillua në Tiranë seminari njëditor kombëtar që synonte të vërtetonte rezultatet e vlerësimit të nevojave të kryera nga SNV

në bashkëpunim me Federatat rajonale Pyjore si dhe të identifikonin nevojat për mbështetje në mënyrë që të hartohej programi I SNV-së për ngritjen e kapaciteteve. Në seminar morën pjesë përfaqësues nga federatat rajonale të Elbasanit, Tiranës, Beratit, Lezhës, Shkodrës, Korcës, Kukësit, Dibrës, Shoqatës Kombëtare, Koordinatorët rajonal të PZHBN, njësia menaxhuese e projektit të PZHBN, Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Këshilltarët e SNV-së dhe Shoqata e Komunave Shqipëtare.

Në seancën e dytë të seminarit morën pjesë misionet e BB. Cështjet kryesore, sugjerimet dhe gjetjet e seminarit ishin:

1. *Pikat e referimit.* Me përfundimin e vlerësimit të nevojave si dhe me përcaktimin e temave kryesore për ngritjen e kapaciteteve, lind nevoja për të identifikuar pikat e referimit për këtë proces ngritje kapacitetesh. Ku do jemi ne pas 4-5 vjetësh? Përcaktimi i pikave të referimit do të kryhet në përiudhën vijuese ku do të përfshihen aktorët kryesorë (Federatat Kombëtare dhe Rajonale si dhe Ministria).

2. *U diskutua Integrimi i grupeve të dobëta në gjithë procesin e pylltarisë komunale.* Nevojitet të jemi shumë të vetëdijshëm për grupet e dobëta në komunitete të cilët po përdorin shpesh tashmë pyje e kullota të cilët mund të humbin kur sistemet e menaxhimit të ndryshohen. Përfitimet janë më të larta se humbjet në përgjithësi si dhe me përfshirjen e grupeve të dobëta (banorëve të varfër) në pylltarinë komunale. Megjithatë mbetet shumë për t'u bërë akoma për përfshirjen e plotë të grupeve të dobëta në shoqëri, vecanërisht kur punohet me rishikimin/bërjen e planeve të menaxhimit duhet të sigurohen të përfshihen interesat e tyre.

3. *U diskutua Proçesi i lobimit në lidhje me ndryshimet e nevojshme në legjislacionin pyjor dhe zotërimin e pyjeve.* Federatat shpjeguan procesin e deritanishëm. Proçesi i lobimit është në vazhdim. Deri tani rezultatet kryesore janë se cështjet po diskutohen gjërësisht si dhe janë sjell në vëmendje në nivel kombëtar. Gjatë seminarit u sollën komentet e tyre si dhe cështje e sugjerime. Një angazhim i plotë i Ministrisë ende mungon dhe nuk ka filluar akoma proçesi me pjesëmarrje. Gjithashtu DSHP shprehu nevojën për të qënë më të përfshirë. Federatat u shprehën se ata do të informojnë/përfshijnë të tjerët më shumë, por janë të mendimit se kjo fillimisht është një përgjegjësi e Ministrisë dhe presin prej tyre që ta ndjekin këtë cështje.

4. *Cështjet e zotërimit të tokës u diskutuan përfshirë transferimin e pronave publike nga Shteti në Qeverinë Lokale për pyjet dhe kullotat.* Shoqata e Komunave shprehu se kjo është e nevojshme në një paketë reforme të plotë ligjore që adreson gjithashtu procesin e decentralizimit në vazhdim. Për të qënë të aftë të menaxhojnë

këto pyje e kullota kompetenca të mëtejshme nevojiten për t'u deleguar në nivel lokal. Prirja për transferimin e pronësisë do të cojë drejt të drejtave të duhura të përdoruesve në nivel individual me një qëllim afatgjatë të pylltarisë private.

5. *Statusi i SHPPKK-ve* (Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale) ka nevojë për rishikim vecanërisht në lidhje me kryerjen e aktiviteteve ekonomike në mënyrë që të kryej sic duhet menaxhimin e qëndrueshme të pyjeve. Kjo çështje sa vjen e bëhet më e nevojshme tani që shumë pyje komunale po rigjenerohen dhe kanë filluar të japin prodhimet e para pyjore. Kompetenca të mëtejshme nevojiten për SHPK-të të cilat duhet të përshtaten me kompetencat e përgjegjësitë e Qeverisë Lokale. Synimi kryesor është të jenë të aftë të menaxhojnë sic duhet pyjet dhe kullotat e tyre në interes të komunave, gjë që do të cojë drejt qëndrueshmërisë financiare.

6. *Lidhur me qëndrueshmërinë financiare* edhe çështjet e taksave dhe tarifave kërkojnë rishikim, nevojitet decentralizim i mëtejshëm për në nivelet lokale (SHPPK dhe Qeveria Lokale). Taksa më të ulëta mund të propozohen për pyjet komunale që kanë dimension dhe përgjegjësi sociale.

7. *Planet e menaxhimit janë një mjet i rëndësishëm për të drejtuar nevojat e komunitetit në lidhje me pyjet dhe kullotat.* Një përpjekje e madhe është bërë tashmë për të përfshirë procesin me pjesëmarrje në procesin e planifikimit. Zhvillime të vazhdueshme nevojiten për të adresuar nevojat lokale si dhe për të pasur përgjegjësi të mëtejshme të decentralizuara. Kjo do të cojë në përfshirjen më të madhe lokale në planifikim dhe zbatim, transparencë dhe përgjegjësi më të larta në nivel lokal. Shërbimi pyjor duhet të jetë mbështetës për këtë duke pasur një funksion të përgjithshëm kontrolli.

8. *Zbatimi i aktiviteteve të projektit* duhet të delegohet me përgjegjësi më të mëdha në nivelet lokale duke shmangur procedurat burokratike. Në përgjithësi procedurat në planifikim, zbatim dhe monitorim duhet të njohin përpjekjet e vazhdueshme për decentralizim. Procedurat e tenderimit në projekt u diskutuan gjërësisht. Të gjithë të pranishmit shprehën vështirësitë në proces në të cilin shumë gjëra nuk ishin komunikuar qartë. Megjithëse kriteret për vetë tenderin mund të jenë transparente një proces i paqartë mund të cojë në shumë vështirësi dhe konflikte.

Në përgjithësi proceset në projekt duhet të mbështesin rolet e aktorëve të ndryshëm (SHPP, Komunë, DSHP, Federata dhe Ministria). Mënyra e zbatimit të projektit duhet të jetë përkrahëse ndaj reformës në vazhdim dhe decentralizimit që cojnë në kapacitete më të larta në nivele lokale.

## Përmbledhje e problemeve të theksuara:

1. Menaxhimi & Organizimi I Brendshëm I Shoqatës
<i>Problemet kryesore</i>
· Mungesë kuptimi të qartë mbi SHPPK-të
· Mungesë menaxhimi I SHPPK-ve
· Mungesë interesi për pjesëmarrje
· Mungesë plani pune
· Mungesë kuptimi se kush është anëtar e kush jo
· Mbledhjet nuk organizohen në përputhje me statutet
· Mungesë pjesëmarrje dhe vendimmarrje e grave
· DSHP nuk ka besim tek SHPPK
· Zgjedhje e anëtarëve të bordit
· Komunikimi ndërmjet bordit dhe anëtarëve
· Mision & vision I paqartë I SHPP për shkak të ndryshimit të emrit në NRMA
· Rolet & përgjegjësitë (shumë të kryera nga kryetari)
· Monitorimi dhe vlerësimi
2.Aspektet Teknike
<i>Problemet kryesore</i>
· Mungesë Informacioni mbi pyjet private/të komunitetit
· Mungesë e pjesëmarrjes në planifikimin dhe zbatimin menaxhues
· Mungesë kapacitetesh në menaxhimin e konflikteve (Bordi)
· Mungesë kapacitetesh për të rishikuar planet e menaxhimit (DSHP)
· Mungesë stafi teknik në komuna
· Teknika të reja për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave
· Pyjet fermere të menaxhuara si pronë e përbashkët
· Nevojitet aftësi administrative/financiare
3. Statusi Ligjor & Pronësia
<i>Problemet kryesore</i>
· Kuadri ligjor nuk është I qartë
· Statuti duket të jenë vetëm një letër zyrtare (askush nuk e njeh)
· NIPT-i nevojitet në aktivitete
· Ndryshimi I emrit nga SHPPK në NRMA
· SHPPK nuk mund të kenë aktivitete fitimprurëse
· Diferenca të mëdha në ide mbi pronësinë (DSHP - private, Komuna - e përbashkët, SHPPK - familjet)
· Mungesë njohjeje të rregulloreve të pronësisë
· Transferimi I të drejtave të pronës tek komunat
· Transferimi I njohurive tek SHPP dhe përdoruesit
4. Komunikimi I Jashtëm
<i>Problemet kryesore</i>
· Komunikimi me federatat rajonale është i rëndësishëm
· Vështirësi kur federatat rajonale nuk ekzistojnë
· Ndryshime në komunikime rajonale: komunat me DSHP
· Krijimi I rrjeteve & të mësuarit ndërmjet shoqatave dhe federatave

Menaxhimi Financiar
<i>Problemet kryesore</i>
· Qeveritë lokale kontrollojnë NFPU's
· Ligji nuk aplikohet për fondin e riinvestimit
· Burokraci ndërmjet aktorëve
· Mosekzistenca e një plani mbi vetë-qëndrueshmërinë
· Asnjë e ardhur tjetër përveç tarifave
· Mungesë transparence & përgjegjshmërie (njerëzit nuk pyesin për të)
· Si të mbidhen tarifafat?
· Mungesë plani për gjenerim fondesh
· Njerëzit janë shumë të varfër për të paguar / krijuar fond riinvestimi
· Mungesë plani gjenerimi fondesh për NTFP

Pas seminarit kombëtar në Tiranë, tre workshope të tjera janë zhvilluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të NFA dhe DFPP, ku diskutohen dhe analizohen në detaje gjithë infomacioni. Si rezultat janë identifikuar grupet përfituese si dhe të gjitha çështjet dhe rastet për mbështetje me trajnime. Bazuar mbi këto një program trajnimi është ndërtuar dhe është prezantuar si një pjesë e raportit të fillimit.

Dymbëdhjetë grupe pune brenda stafit të SNV-së janë ngritur për të përgatitur 12 modulet e trajnimit të përcaktuara sipas grupeve përfituese. Për secilin modul janë hartuar çështjet dhe afati për përfundimin e tyre. Modulet e para do t'i adresohen anëtarëve të SHPPK-ve. Grupet e punës filluan të mblidhnin dokumenta ekzistues si dhe informacione të tjera të përshtatshme. Drafti I parë është diskutuar ndërmjet këshilltarëve të SNV-së gjatë janarit dhe bazuar mbi vërejtjet dhe komentet grupet e punës po përfundojnë modulet. Grupet e tjera janë në përgatitje të drafteve të para. Më shumë detaje në lidhje me modulet e trajnimit mund të gjenden në tabelën e mëposhtme:

### 6.1. Programi i trajnimit

AKTIVITETE	2007	2008	2009	2010	2011
<b>1. Zhvillimi i një manuali trajnimi ose ngritje kapacitetesh.</b>					
një module mbi trajnimin e trajnerëve	<b>1 mod</b> SNV				<b>1 module</b>
Një seri modulesh për nevojat specifike trajnuese	<b>8 mod</b> SNV	<b>5 mod</b> SNV	<b>2 mod</b> SNV		<b>15 module</b>
1. Trajnim të trajnerëve të nivelit rajonal.	<b>3 train</b> SNV Fed.	<b>3 train</b> SNV. Fed.	<b>3 train</b> Nat. Fed.		<b>9 trajnims</b> (njëhere në vit)

## 6. Modulet dhe program i trajnimit (Nëntor - Dhjetor 06)

AKTIVITETE	2007	2008	2009	2010	2011
2. Trajnim për përfaqësuesit e komunës / fshatit.	<b>3 train</b> SNV Nat	<b>3 train</b>	<b>3 train</b> SNV Nat	<b>3 train</b>	<b>12 trajnims</b> (njëhere në dy vjet)
3. Ngritje i grupit fleksibël i trajnuesve lokal	<b>30 prof</b> SNV	<b>50 prof</b> SNV Fed.	<b>80 prof</b> Nat. Fed.	<b>20 prof</b> Nat. Fed.	<b>180 profesionistë</b>
4. Përfaqësues të komunës ndërmarrin trajnime dhe aktivitete ngritje kapacitetesh në nivel fshati.					
Teknikët e SHPP në nivel rrethi.	<b>40 train</b> SNV	<b>40 train</b> Nat. SNV	<b>40 train</b> Nat. SNV	<b>30 train</b> Nat.	<b>150 trajnime</b> (njëhere/dy herë cdo muaj nga shoqatat kombëtare)
Anëtarët e bordit të SHPPK në nivel komune	<b>100 train</b> SNV.	<b>150 train</b> Fed. SNV.	<b>100 train</b> Fed. SNV.	<b>100 train</b> Fed.	<b>450 trajnime</b> (njëhere/dy herë cdo muaj nga federatat)
Ndërgjegjësimi i anëtarëve të SHPPK në nivel fshati	<b>1000 train</b> Fed.	<b>1.500 train</b> SHPPK's Fed.	<b>1.000 train</b> SHPPK's Fed.	<b>550 train</b> SHPPK's	<b>4.050 trajnime</b> (njëhere cdo dy javë nga bordi i SHPPK)
5. Përditësimi i moduleve të trajnimit apo të ngritjet të kapaciteteve				<b>16 mod</b> SNV	16 module të publikuara

## 6.2. Module Trajnimi

### 6.2.1. Anëtarët e SHPPK

Emri i Modulit	Çështjet	Afati kohor
1. Vendosja e Programit të Ndërgjegjësimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Funksionim i Përgjithshëm</li> <li>Informacion themelor mbi pylltarinë komunale</li> <li>Transparencë &amp; përgjegjshmëri</li> <li>Pjesëmarrje &amp; Balancë gjinore</li> </ul>	Janar, 07
2. Zbatimi i Programit të Ndërgjegjësimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Funksionim i Përgjithshëm</li> <li>Informacion themelor mbi pylltarinë komunale</li> <li>Transparencë &amp; përgjegjshmëri</li> <li>Pjesëmarrje &amp; Përkatesi gjinore</li> </ul>	Janar, 07
3. Program Ndërgjegjësimi i Avancuar	<ul style="list-style-type: none"> <li>Informacion mbi gjenerim të ardhurash</li> <li>Situata ligjore &amp; të drejtat e pronës</li> <li>Të tjera për t'u përcaktuar sipas nevojave</li> </ul>	Prill, 07
<b>Grupi përfitues</b>		
Përdorues të pyjeve dhe kullotave komunale/fshatarë në nivele fshati		

6.2.2. Anëtarë bordi SHPPK

Emri i Modullit	Çështjet	Afati kohor
1. Mjet Vlerësimi i Organizatës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Funksionim i Përgjithshëm</li> <li>Menaxhim i Pyjeve</li> <li>Komunikim</li> <li>Pjesëmarrje</li> </ul>	Janar, '07
<b>Grupi përfitues</b>		
Të gjithë anëtarët e bordit të SHPPK + pyjëtari komunal + përfaqësuesit e Komunës (1-2 persona: Kryetari, përgjegjësi për bujqësinë/pyjet, përgjegjësi për financën)		
2. Moduli i Menaxhimit Financiar / Qëndrueshmërisë (përfshin komunën)	<ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitete gjenerimi të ardhurash</li> <li>Vetë qëndrueshmëri financiare</li> </ul>	Prill '07
<b>Grupi përfitues</b>		
Të gjithë anëtarët e bordit (ose të paktën ata të përfshirë në financë/admin) e SHPPK + pyjëtari komunal + përfaqësuesit e Komunës (1-2 persona: Kryetari, përgjegjësi për bujqësinë/pyjet, përgjegjësi për financën)		
3. Trajnim i Specializuar për SHPPK-të, Komunë & DSHP	<ul style="list-style-type: none"> <li>Vetë-qëndrueshmëri financiare</li> <li>Menaxhim konflikti</li> </ul>	Mars, '07
<b>Grupi përfitues</b>		
Kryetarë, Pyjëtar komunal, përfaqësues nga Komuna, përfaqësues të DSHP		

6.2.3. Teknikët e SHPPK-së

Emri i Modullit	Çështjet	Afati kohor
1. Menaxhimi i Pyjeve në Bashkëpunim	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plane menaxhimi të pyjeve</li> <li>Metoda &amp; teknika në menaxhimin e pyjeve</li> <li>Përshkrimi i parcelave</li> <li>Vizita në terren</li> </ul>	Shkurt '07
2. Praktika për Pyjet Fermere	<ul style="list-style-type: none"> <li>Informacion mbi pyjet fermere</li> <li>Metoda &amp; teknika në pyjet fermere</li> <li>Modele</li> <li>Vizita në terren</li> </ul>	Shkurt '07
3. Module të tjera të mundshme	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për t'u përcaktuar....</li> </ul>	Prill '07
<b>Grupi përfitues</b>		
Pyjëtari Komunal në Komunë dhe/ose nga SHPPK + Pyjëtarët Komunal/inxhinierë pyjesh nga Federata + përfaqësues të DSHP		

## 6.2.4. Federatat

Emri i Modullit	Çështjet	Afati kohor
1. Çështje të specializuara trajnimi për t'u përdorur gjatë takimeve me Mbledhjen e Përgjithshme dhe Bordin sipas nevojave në aktivitetet e lartpërmendura 1 dhe 3.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çështjet:               <ul style="list-style-type: none"> <li>o Vetë-qëndrueshmëria financiare</li> <li>o Lobim dhe Advokim</li> <li>o Pyjet fermere/ Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve</li> <li>o Çështje të tjera...</li> </ul> </li> </ul>	Mars '07
2. Ngritje i lidhjeve / organizimi i vizitave shkëmbyese: vizita ndërmjet FUA - FUA me përfshirjen e Komunë/ DSHP, vizita ndërmjet FUA me përfshirjen e DSHP, Shoqata Kombëtare	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Disa në vit në rajonin e (FUA tek FUA)</li> <li>- 1-2 vizita rajonale për Federatë gjatë periudhës së projektit (nga Rajoni në Rajon). Në këto përfshihet gjithashtu edhe Shoqata Kombëtare</li> </ul>	Mars '07
<b>Grupi përfitues</b>		
FUAs, Komunë, Federatat Rajonale dhe Shoqata Kombëtare, DSHP		

## 6.2.5. Shoqata Kombëtare

Emri i Modullit	Çështjet	Afati kohor
1. Çështje të specializuara trajnimi për t'u përdorur gjatë takimeve me Mbledhjen e Përgjithshme dhe Bordin sipas nevojave në aktivitetet e lartpërmendura 3 dhe 5.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Çështjet               <ul style="list-style-type: none"> <li>o Vetë-qëndrueshmëria financiare</li> <li>o Lobim dhe Advokim</li> <li>o Çështje të tjera...</li> </ul> </li> </ul>	Shkurt '07
2. Zhvillimi i pikat e referimit/baseline	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njëherë</li> </ul>	
<b>Grupi përfitues</b>		
Shoqata Kombëtare dhe Federatat Rajonale		

SNV në bashkëpunim me ECAT po zhvillojnë një studim themelor për pyjet komunale në Shqipëri me objektivat specifike; (i) mbledhjen dhe zhvillimin e një sistemi informacioni bazuar në GIS mbi informacionin ekzistues social-mjedisor në Shqipëri, (ii) zhvillimi i një baze të dhënash MS Access për sistemin e monitorimit / vlerësimit të programit të ngritjes së kapaciteteve. Studimi themelor përfshin: informacionin mbi kontaktet, informacion të përgjithshëm për komunitat dhe fshatrat, informacion të përgjithshëm për SHPPK-të, informacion të përgjithshëm për federatat, informacion të përgjithshëm për shoqatën kombëtare, informacion mbi menaxhimin e pyjeve në bashkëpunim e programin e ngritjes së kapaciteteve si dhe informacionit GIS në nivel komune. Mbledhja e informacionit filloi që në fillim të muajit dhjetor dhe procesi është në vazhdim, e sipas kontratës do të përfundojë në mars 2007.

Sic është paraqitur në projekt propozimin, një nga parimet kryesore të SNV-së, është ngritja e një grupi trajnuesish. Për shkak të nevojave për ngritjen e kapaciteteve SHPPK-të kërkojnë një gamë të gjërë njohurish dhe aftësish që variojnë nga aftësitë teknike (menaxhimi i pyjeve) deri në forcimin organizativ. Prandaj, është propozuar të ngrihet një grup fleksibel trajnerësh lokal, të përcaktuar në përputhje me nevojat e SHPPK-ve si dhe disponueshmërinë e ekspertizës lokale. Për secilin rajon një grup I tillë do të vendoset duke ftuar të marrin pjesë specialistë nga disiplina të ndryshme. Trajnuesit mund të vijnë nga fusha të ndryshme: anëtarë ose staf të SHPPK/Federatave, staf i institucioneve qeveritare (lokale), anëtarë/staf të OJQ-ve lokale, konsulentë privatë. Në përputhje me gjithë aktivitetet e projektit në komuna/rrethe/rajone të ndryshme dhe nevojat për trajnim është rënë dakort të ngrihen 8 grupe trajnuesish në rajone të ndryshme të Shqipërisë. Secili grup trajnuesish do të ketë 3-5 persona të përzgjedhur bazuar në kriteret e lartpërmendura.

Një grup specifik po përgatit module për trajnimin e trajnerëve. Modulet janë pothuajse hartuar dhe seminare dy ditore rajonale do të zhvillohen gjatë Shkurtit 2007.

## 7. Zhvillimi i një studimi themelor - Dhjetor 2006

## 8. Trajnimi i trajnerëve

## 9. Dhënia e trajnimeve. (Dhjetor 2006)

Paralelisht me të gjithë procesin përgatitor, SNV në bashkëpunim me stafin e PZHBN, DFPP, SHKP dhe konsulentët privatë filluan që në nëntor 2006 dhënie të trajnimeve për anëtarët e SHPPK-së (grupi qëndror për komisionet e fshatit) dhe bordi I SHPPK-ve. Trajnime të tilla janë dhënë në komunat: Stebleve (Librazhd), Macukull (Mat), Baz (Mat), Rubik (Miredite), Orosh (Miredite), Sult (Gramsh), Tregan (Elbasan), Gore (Korce), Aranitas (Ballsh), Lumas (Berat), Kastrat (M.Madhe) etj. Këto komuna janë në fazën e rishikimit/përgatitjes të planeve të menaxhimit ku çështjet më kryesore janë: pjesëmarrja e komuniteteve locale në proces, zgjedhja e komisioneve të fshatit, ngritja e SHPPK-ve (në rast të komunave të reja) matura për procesin e transferimit dhe menaxhimit në bashkëpunimin të pyjeve etj.

Krijimi i Federatave të reja. Për shkak të një procesi shumë aktiv të zhvilluar deri tani përmes projektit të SIDA gjatë muajit dhjetor është përfunduar takimi I përgjithshëm për vendosjen e federatave të pyjeve në rajone të tjera. Si rezultat janë ngritur Federata të reja Pyjore në rajonet e Elbasanit, Shkodrës dhe Lezhës, ndërsa në rajonet e Beratit dhe Pukës janë ngritur gjatë periudhës maj-qershor 06.

## 10. Rezultatet

Deri tani planifikimi ka qënë realist, si dhe progresi i konsiderueshëm është bërë për t'i realizuar ato. Në lidhje me qëllimin dhe afatin kohor, SNV është përpara planit dhe asnjë pengesë madhore nuk ka ndodhur. Këshilltarët dhe stafi i SNV kanë përdorur mirë vullnetin e dëshirën e mirë të SHPPK për të filluar PZHBN dhe me ritme të shpejta mbuluan të gjithë vendin me një skuadër të zgjeruar në terren. Sfidat më të madhe për periudhën e ardhshme do të jetë të mbahet lart kjo energji dhe motivim në vazhdimësinë e PZHBN, si dhe të përshtatet zbatimi i aktiviteteve të kryera nga DFPP me aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve të SNV-së. Rrjedhimisht nevojitet koordinim dhe komunikim mjaft i mirë me stafin e NjMP.

Disa arritje të rëndësishme ishin:

- Marrëveshja teknike dhe financiare e miratuar dhe nënshkruar ndërmjet SNV dhe NjMP.
- 285 Fshatra, 138 Komuna, 30 Rrethe dhe 11 Rajone u mbuluan gjatë vlerësimit të nevojave.
- 558 anëtarë të SHPPK-ve, 186 anëtarë të bordit, 118 nënpunës komunash dhe 63 drejtorë dhe/apo specialistë ose DFS u intervistuan nga aspekti organizativ, komunikues, ligjor e financiar.
- 44 intervistues (15 këshilltarë të SNV-së dhe 29 intervistues nga Federatat) u përfshinë në procesin e

mbledhjes së të dhënave.

- Tre tryeza të rrumbullakëta ekspertësh u organizuan për të komentuar dhe reflektuar mbi pyetëtorët dhe metodologjinë e grumbullimit të të dhënave si dhe përpunimin e tyre.
- Katër trajnime u organizuan për 44 intervistuesit mbi grumbullimin e të dhënave dhe teknikat e intervistimit.
- 16 teste pilote u ndërmorën në 4 rajone të ndryshme për të vlerësuar metodologjinë dhe aftësitë e intervistimit.
- Një workshop kombëtar u organizua për të vlerësuar procesin e përdorur gjatë vlerësimit të nevojave.
- 12 module trajnimi janë identifikuar dhe po përgatiten
- 30-40 trajnues lokal janë përzgjedhur dhe do të kenë trajnim special.
- 11 trajnime në nivel komune janë dhënë me vëmendje ndaj komisioneve të fshatit dhe anëtarëve të bordit.
- Po përgatitet një studim themelor mbi sektorin e pyjetarisë komunale në Shqipëri

	Emri i Punonjësve	Pozicioni	Norma Ditore	Ditët e Planifikuara 2006	Ditët Totale
1	Arie Klop	Koordinator	1,100	100	30
2	Sheza Tomcini	Këshilltar	300	110	76
3	Hamit Salkurti	Këshilltar	300	110	88
4	Almira Xhembulla	Këshilltar	300	50	12
5	Natasha Mazari	Këshilltar	300	25	1
6	Lindita Manga	Këshilltar	300	25	3
7	Dali Horeshka	Këshilltar	300	25	11
8	Isuf Omuri	Këshilltar	300	115	79
9	Stavri Pllaha	Këshilltar	300	120	72
10	Albana Cule	Këshilltar	300	50	20
11	Elona Stefanllari	Këshilltar	300	50	12
12	Janaq Male	Këshilltar	300	120	79
13	Ermira Lubani	Këshilltar	300	50	36
14	Jetona Myteveli	Këshilltar	300	50	8
15	Harko Koster	Këshilltar	300		47
15	Te tjere	Këshilltarë	300		94
	<b>Ditët totale</b>			<b>1,010</b>	<b>678</b>

## 11. Ditët e Këshillimit

## 12. Raporti Financiar

### 12.1. Raporti Financiar 2006 (Tremujorët 1 dhe 2)

BUXHETI I PËRGJITHSHËM 2006 (USD)							
	Planifikuar II	Planifikuar III	Planifikuar IV	Planifikuar 2006	Shpenzuar I	Shpenzuar II	Shpenzuar 2006
Buxhet SNV	113,500	102,500	100,500	<b>316,500</b>	157,925	88,075	<b>246,000</b>
Buxhet WB	35,500	47,500	67,500	<b>150,500</b>	52,689	13,105	<b>65,794</b>
<b>Buxheti Total</b>	<b>149,000</b>	<b>150,000</b>	<b>168,000</b>	<b>467,000</b>	<b>210,614</b>	<b>101,180</b>	<b>311,794</b>

TË ARDHURA (KOSTO TOTALE KONSULENCE) 2006 (USD)							
	II	III	IV	Planifikuar	Shpenzuar 1ST QRT	Shpenzuar 2ND QRT	Shpenzuar 2006
Buxhet SNV	113,500	102,500	100,500	<b>316,500</b>	157,925	88,075	<b>246,000</b>
Buxhet WB	22,500	22,500	22,500	<b>67,500</b>	33,375	7,725	<b>41,100</b>
<b>Buxheti Total</b>	<b>136,000</b>	<b>125,000</b>	<b>123,000</b>	<b>384,000</b>	<b>191,300</b>	<b>95,800</b>	<b>287,100</b>

KOSTO TË RIMBURSUESHME 2006 (USD)							
Tremujori	II	III	IV	Planifikuar	Shpenzuar 1ST QRT	Shpenzuar 2ND QRT	Shpenzuar 2006
1. Vlerësimi i nevojave / ndjekja/rishikimi	10,000	3,000		<b>13,000</b>	9,998.28	3,680	<b>13,679</b>
2. Analiza e situatës	1,000	3,000		<b>4,000</b>	4,481.27	796	<b>5,278</b>
3. Trainimi i trajnerëve	2,000	3,000		<b>5,000</b>	4,834.65	297	<b>5,131</b>
4. Përgatitja e moduleve të trajnimit		3,000	2,000	<b>5,000</b>			<b>0.00</b>
5. Programet e ndërgjegjësimit (nivel fshati)		10,000	25,000	<b>35,000</b>		605.37	<b>605.37</b>
6. Trajnimi/mbështetja Org & Teknike të SHPPK-ve		3,000	15,500	<b>18,500</b>			<b>0.00</b>
7. Monitorimi / Vlerësimi			2,500	<b>2,500</b>			<b>0.00</b>
<b>Kosto totale mbështetëse të programit (vetëm BB)</b>	<b>13,000</b>	<b>25,000</b>	<b>45,000</b>	<b>83,000</b>	<b>19,314</b>	<b>5,380</b>	<b>24,694</b>

Për tremujorin e tretë (tremujorin e parë të 2007), aktivitetet do të zbatohen në përputhje me propozimin teknik dhe plane pune specifike do të zhvillohen për secilin klient. Vëmendje të vecantë do t'u jepet aktiviteteve në lidhje me zhvillimin e moduleve të trajnimit, trajnimit të trajnerëve si dhe dhënien e trajnimeve në nivel fshati në përputhje me programin e trajnimit të paraqitur në raportin e fillimit. Dy muajt e parë do të jenë më shumë fazë përgatitore si dhe do të fillojnë disa trajnime, ndërsa në gjysmën e dytë të tremujorit do të jepen seri të plota seminaresh të cilat do të vazhdojnë në tremujorët e tjera të vitit.

Për vitin 2007, ndarja e mëposhtme është llogaritur:

## 13. Planifikimi i Tremujorit të tretë (Janar - Prill 2007)

TREMUJORI	I	II	III	IV	TOTAL
<b>Advisory ditë</b>					
Këshilltarë Kombëtar	100	200	300	300	900
Kësh. Brend.(koordinim)	20	20	30	30	100
Këshilltar të jashtëm	0	5	10	5	20
Ditë këshillimi totale	120	225	340	335	1020

<b>PROGRAM SUPPORT (USD) AKTIVITETE PËR NGRITJEN E KAPACITETEVE 2007</b>					
	I	II	III	IV	TOTAL
1. Zhvillimin e një manuali trajnimi apo ngritje kapacitetesh.					
a. Një modul mbi trajnimin e trajnerëve	500				500
b. Një seri modulesh mbi nevojat specifike për trajnim	5,000				5,000
2. Trajnim i trajnuesve të nivelit rajonal.	1,500				1,500
3. Trajnim në nivel kombëtar.		1,500	2,000	2,000	5,500
4. Ngritja e një grupi fleksibël trajnuesish lokal	3,000	1,500			4,500
5. Përfaqësues rajonal ndërmarrin aktivitete trajnuese dhe ngritje kapacitetesh në nivel komune.					
a. Teknikët e SHPPK-ve		1,000	1,000	2,000	4,000
b. Anëtarët e bordit të SHPPK-ve	2,000	2,000	3,000	3,000	10,000
c. Ndërgjegjësimi i anëtarë të SHPPK-ve	5,000	12,000	15,000	15,000	47,000
d. Përditësimi i moduleve të trajnimit apo ngritjet të kapaciteteve.				1,500	1,500
<b>AKTIVITETE TË TJERA</b>					
1.Pikat e referimit / studimi themelor	3,000				3,000
2.Ngritje i lidhjeve institucionale				3,000	2,000
3.Monitorimi / vlerësimi				2,500	2,500
a. PROGRAM SUPPORT					
b. Buxhet SNV	3,000				3,000
c. Buxhet BB (PZHBN)	17,000	18,000	21,000	29,000	85,000
d. TOTAL	20,000	18,000	21,000	29,000	88,000

**KOSTO KËSHILLIMI (USD), 2007**

	I	II	III	IV	TOTAL
Buxhet SNV	51,500	92,500	75,000	92,500	<b>312.500</b>
Buxhet BB (PZHBN)	10,000	15,000	21,000	21,500	<b>67.500</b>
<b>TOTAL</b>					<b>380.000</b>

**Këshilltarë Kombëtar (USD)**

	I	II	III	IV	TOTAL
ër ditësh	100	200	300	300	<b>900</b>
	24,000	65,500	48,000	65,000	<b>202.500</b>
Buxhet SNV	10,000	15,000	21,000	21,500	<b>67.500</b>
Buxhet BB (PZHBN)	<b>24,000</b>	<b>63,000</b>	<b>86,500</b>	<b>86,500</b>	<b>380.000</b>

**TOTAL****Këshilltarë ndërkombëtar (USD)**

	I	II	III	IV	TOTAL
Number days	25	25	25	25	<b>100</b>
Buxhet SNV	27,500	27,000	27,000	27,500	<b>110.000</b>
Buxhet BB (PZHBN)	-	-	-	-	<b>-</b>
<b>TOTAL</b>	<b>27,500</b>	<b>27,500</b>	<b>27,500</b>	<b>27,500</b>	<b>110.000</b>